

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 96/19 dhe 110/19), si dhe në bazë të nenit 22 dhe neni 25 të Ligjit për arsim të mesëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/18) ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin mësimor të shkurtuar për lëndën zgjedhore **Logjikë për vitin IV (e katërt) të arsimit të mesëm - gjimnaz** për vitin shkollor 2020/2021.

1. HYRJE

Programi mësimor i shkurtuar, i lëndës **Logjikë**, lëndë zgjedhore për vitin IV (e katërt), bazohet në qëllimet e parashikuara në programin mësimor për lëndën mësimore që rregullisht realizohet sipas planit mësimor të përcaktuar.

Me programin e shkurtuar përcaktohen tema dhe njësi mësimore të caktuara që duhet të realizohen në 145 ditë mësimore, gjatë së cilës konsiderohet fondi i paraparë javor i orëve të përcaktuar në programin e rregullt, respektivisht për një lëndë mësimore me fond javor prej 2 orë, në programin e shkurtuar parashikohen 58 orë mësimore.

Mësuesi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar, drejtohet kah qëllimet/rezultatet e parashikuara, nocionet e përcaktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I TEMAVE DHE NJËSIVE MËSIMORE

TEMA I: LOGJIKA SI SHKENCË (6 ORË)

Njësitë mësimore:

- Kuptimi i nocioneve logjikë, logjike, i palogjikshëm, alogjike dhe nocione të tjera që rrjedhin prej tyre që përdoren në komunikimin e përditshëm
- Racionaliteti dhe logjika
- Lënda e logjikës
- Disiplinat logjike: logjika formale, teoria e njohjes, metodologjia dhe raportet e tyre të ndërsjellta
- Raporti i logjikës me disiplinat e tjera shkencore: psikologjia, matematika, linguistika etj.

TEMA II: KOMUNIKIMI, MENDIMI DHE GJUHA (12 ORË)

Njësitë mësimore:

- Koncepti për komunikimin dhe supozimet e nevojshme për të kuptuar dhe kryer komunikimin
- Gabimet logjike gjatë të shprehurit
- Mendimi dhe karakteristikat themelore logjike të tij: saktësia, paqartësia, sistematizmi, arsyetimi, jokontradikta etj.
- Mendimi dhe gjuha, fjalët dhe konceptet
- Nocioni, tiparet themelore të nocionit, llojet e nocioneve dhe raporti midis nocioneve
- Metodatat për formimin e nocioneve: analiza, sinteza, abstraksioni, gjeneralizimi dhe konkretizimi.
- Metodatat për shpjegimin dhe specifikimin e nocioneve: përkufizimi, ndarja e nocionit dhe klasifikimi.

TEMA III: GJYKIMET (18 ORË)

Njësitë mësimore:

- Fjala dhe gjykimi
- Llojet e gjykimeve sipas strukturës së tyre: gjykimet elementare dhe të përbëra
- Metodatat për formimin e gjykimeve elementare
- Metoda empirike: vëzhgimi dhe eksperimenti
- Numërimi dhe matja
- Metodatat statistikore: vlerat mesatare, masat e shpërndarjes, masat e korrelacionit
- Gjykimet e përbëra
- Funkcionet vërtetësisë: mohimi, konjunksioni, disjunksioni, implikacioni, ekuivalenca.
- Tabelat e vërtetësisë si një metodë për të zbuluar vlerën e vërtetësisë të gjykimeve të përbëra
- Ndarja e gjykimeve të përbëra sipas vlerës së vërtetësisë: gjithmonë gjykime të vërteta, gjithmonë kontingjente të rreme
- Ligjet e logjikës: kuptimi tradicional dhe bashkëkohor

TEMA IV: NXJERRJA DHE PROVA E GJYKIMEVE (15 ORË)

Njësitë mësimore:

- Nocioni për argumentimin: supozimet dhe nxjerrja
- Vërtetësia dhe vlefshmëria
- Sekuenca logjika
- Llojet e argumentimit
- Lloji induktiv i argumentimit: nxjerrja e përfundimeve të munshme nga premiset e vërteta
- Induksioni jo i plotë
- Analogjia
- Lloji deduktiv i argumentimit: nxjerrja e përfundimeve të vërteta nga premiset e vërteta
- Mjetet e drejtpërdrejta logjike
- Silogjizmi (Aristotel, qasja tradicionale dhe bashkëkohore)
- Metoda aksiomatike
- Lloji dialektik i argumentimit: nxjerrja e përfundimeve të munshme nga supozimet e mundshme
- Reaktivizimi i domethënies logjike: implikimi konverzativ, presupozimi
- Gabimet logjike: sofizmat, paralogjizmat

TEMA V: SUPOZIME LOGJIKE PËR KRIJIMIN E NJË SISTEMI SHKENCOR (7 ORË)

Njësitë mësimore:

- Nocioni i shkencës
- Njohuritë shkencore, ligjet shkencore, sistemi shkencor
- Struktura e sistemit shkencor
- Nocionet themelore, nocionet e definuara
- Aksiomat, teoremat

3. REKOMANDIME DIDAKTIKE

Pika fillestare për realizimin e programit të shkurtuar mësimor nga lënda **Logjikë**, lëndë zgjedhore për **vitin IV (e katërt)**, është programi i rregullt mësimor (qëllimet konkrete, nocionet, aktivitetet dhe metodat e rekomanduara). Është i nevojshëm një planifikim i integruar, respektivisht lidhshmëri e qëllimit dhe përmbajtjes si dhe planifikim i mësimit me lidhshmerinë të mësuarit me përvojën e nxënësve.

Për realizimin e lëndës mësimore, patjetër të zbatohen metoda dhe forma interaktive (teknika dhe aktivitete të të mësuarit). Nga metodat interaktive do të përdoren: puna në grupe, diskutime, debate, stuhi idesh, analiza e teksteve dhe dokumenteve, analiza e rasteve, por edhe metoda tradicionale: leksione të shkurta, biseda drejtuese. Metodatat e punës së mësuesve duhet të nxisin të menduarit kreativ tek nxënësit dhe shfrytëzimin e burimeve të ndryshme të njohurive. Rekomandimet për përdorimin e fondit të shkurtuar të orëve janë dhënë si orientim, së bashku me qëllimet konkrete dhe temat/përmbajtjet që nuk duhet të kufizojnë rishpërndarjen e tyre sipas nevojave gjatë realizimit.

Kontrollimi i diturive të nxënësve duhet të kryhet në të gjitha fazat e procesit mësimor, gjatë realizimit të përmbajtjes së re, përsëritjes, ushtrimeve dhe hulumtimeve. Gjatë ndjekjes dhe vlerësimit zbatohen veprime të ndryshme (kontrollim me gojë dhe me shkrim, testet e njohurisë, përgatitja e punimeve seminarike si dhe aktivitetet e nxënësit gjatë orës).

Mësuesi do të përdorë mjete ndihmëse dhe mësimore që janë të përcaktuar me programin e rregullt mësimor.

4. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

Programin e shkurtuar mësimor e realizon mësimdhënësi në përputhje me normativin për kuadër mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor për lëndën zgjedhore **Logjikë** për **vitin IV (e katërt)** të arsimit të mesëm- gjimnaz, e miratoi

Ministri i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska